

24.01.2011

## Komunikatë për shtyp

### **Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ) fillon punën**

Bonn/Eschborn, janar 2011. Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ) GmbH nisi punën në fillim të vitit 2011. Kjo organizatë kombinon ekspertizën dhe përvojën shumëvjeçare të Shërbimit Gjerman për Zhvillim (Deutschen Entwicklungsdienstes - DED GmbH), Bashkëpunimit Teknik Gjerman (Deutschen Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit - GTZ GmbH) dhe Edukimit të Mëtutjeshëm dhe Zhvillimit Ndërkombëtar (InWent – Internationale Weiterbildung und Entwicklung GmbH).

Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ) GmbH është pronë e Republikës Federale të Gjermanisë. GIZ është aktiv në mbarë botën në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm dhe në sektorin e edukimit ndërkombëtar. Mandati i GIZ-së është që të përkrahë Qeverinë Gjermane në zbatimin e objektivave në fushat e lartpërmendura. GIZ ofron zgjidhje praktike dhe largpamëse për çështje politike, ekonomike, ekologjike dhe të zhvillimit social në një botë të globalizuar. Duke punuar në kushte të vështira, ne promovojmë reforma komplekse dhe procese ndryshimesh. Qëllimi ynë korporativ është që të përmirësohen kushtet e jetesës për njerëzit në mënyrë të qëndrueshme

GIZ vepron në më shumë se 130 vende në mbarë botën. Selia kryesore e GIZ-së ndodhet në Bonn dhe Eschborn. Në Gjermani, ajo është e pranishme në pothuajse të gjitha shtetet federale gjermane. Kjo organizatë ka 16.862 të punësuar (2010).

**Në vitin 2010 GIZ ka pasur një qarkullim vjetor dhe grante në shumë prej 1,9 miliardë Euro.**